



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujevo

## KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 5 shkronja d) të Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat, përgjegjësitë procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo – arsimor dhe aftësues para universitar, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe 19 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, në propozim të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2023, miratoi këtë,

### VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS

#### Neni 1

Për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore në Komunën e Podujevës, për një (1) vit shkollor, ngritët komisioni përzgjedhës, në këtë përbërje:

1. **Blerim Vllasa**, zyrtar për arsimin e mesëm të lartë në Drejtorinë e Arsimit, kryesues
2. **Nazif Sheqa**, kryetar i Këshillit të prindërve në nivel komune, anëtar
3. Përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, anëtar/ e, i/e cili/a caktohet nga po kjo Ministri

Nga shkolla përkatëse caktohen dy përfaqësues të Këshillit Drejtues (një prind dhe një mësimdhënës) në cilësinë e vëzhguesve.

#### Neni 2

Komisioni punët dhe detyrat i kryen në pajtim me dispozitat e Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, dhe Udhëzimit Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat, përgjegjësitë procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo – arsimor dhe aftësues para universitar.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-020/04-0008896/23  
Podujevë, datë, 31 janar 2023



Kryesuesi i Kuvendit  
Hilmi Hoxha